Selmans Network

Jakov Xoxa, Kompleksi Blini 2
10000, Prishtinë, Kosovë
+383 (0) 45/49 544 544
info@selmans.net
www.selmans.net

Nr.prot. 003-01/2024 **Dt.08.01.2024**

PER: ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK

ANKESË

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: UNIVERSITETI I PRISHTINËS

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**242-23-12923-2-1-1**
Nr i brendshëm	**90400/23/050/211**

Sa i përket tenderit për **:**

PASTRIMI DHE MIRËMBAJTJA E HAPËSIRAVE TË JASHTME DHE TË BRENDSHME TË OBJEKTEVE TË UP-së

1. **Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK**

TË DHËNAT PËR KOMPANINË		VULA
Emri :	**SELMANS NETWORK SH.P.K.**	
Adresa e plotë:	**Rr. Jakov Xoxa, Kompleksi Blini 2, p.n**	
I përfaqësuar nga:		
Emri dhe pozita	**Betim SELMANAJ – Drejtor**	
Nënshkrimi		

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: *Afati per dorzimin e ofertave: 09.01.2024 ora 13:00*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

LPP 04/L-042, LPP 05/L-068, LPP 05/L-092

Neni 7. Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi

Neni 28. Specifikimet teknike

RRUOPP,

Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit

Neni 18. Dosja e tenderit

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës gjatë hartimit të dosjës së tenderit ka vepruar në kundërshtim me Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për prokurim publik

Duke parë dhe duke analizuar dosjen e prokurimit per kete procedure kritereve te vendosura ne specifikimet teknike dhe kërkesave te dosjes se tenderit ne FDT neni 9. ***Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale*** 9.1 dhe 9.2 ***Kapaciteti teknik dhe professional*** Kërkesa 7. ***Lista e mjeteve dhe pajisjeve dhe mjeteve që duhet ti posedoj OE***. Tek ***Deshmitë e kërkuara dokumentare***, dëshmia 7, kërkohet: ***Paisjet të dëshmohen përmes librezave valide të mjetit, mirëpo në rastë se pajisjet nuk janë në pronësi të ofertuesit, dëshmia të jetë marrëveshje e huazimit e nënshkruar nga të dy palët përmes kontratës së noterizuar..... Një traktor me lopatë për largimin e deborës jo më e madhe se 1123cm^3 .....dhe njëtraktor me lopatë për largimin e deborës jo më të mëdha se 999 cm^3....*** shihet qarte që janë kritere diskriminuese për shumë OE dhe favorizuese për OE të caktuar.

AK Universiteti i Prishtinës qëllimisht ka vendosur kritere dhe kërkesa që bien në kundërshtim të plotë me LPP, **Neni 7. Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi**, pika 3 ku thuhet: *Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohetqë të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim **të favorizojë ose diskriminojë** kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik,* **Neni 28. Specifikimet teknike,** pika 2 "*Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. **Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik***. Dhe është në kundërshtim me **RRUOPP, Neni 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, 4.3, c: "**Drejtësia/Mos-diskriminimi – Të veprohet në mënyrë të drejtë gjatë tërë ciklit të prokurimit pa imponuar

obligime të panevojshme ose pengesa për Operatori Ekonomik ose Operatori Ekonomik potencial. Të shmanget çdo trajtim që favorizon një furnizues të caktuar ose furnizues potencial" dhe nenit 18 të po të njejtës rregullore 18. Dosja e tenderit: "Është e ndaluar përgatitja e Dosjes së Tenderit në një mënyrë që favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë Operatorëve Ekonomik potencial.

Kriteri ku përcaktohet lloji i mjetit "traktor" dhe kapaciteti kub i mjetit ose fuqia motorrike e tij, si psh: 1123m^3 verehet qartë se AK përmes kësaj kërkese ka favorizuar OE të caktuar duke diskriminuar OE tjerë të cilët mund të kenë pisje shumë më të sofistikuara dhe më moderne për pastrimin e borës. Me peshë më të vogël por me fuqi me të madhe motorike dhe ngarkuese apo shkarkuese.

Lloji i mjetit i përcaktuar si "Traktor" nuk është as i përshtatshëm për pastrimin e hapësirave të jashtme të Universitetit të Prishtinës jo vetëm për faktin se është mjet i pasigurtë dhe jo komfort për periudhën e dimrit dhe është në kundërshtim të drejtpërdrejt me kërkesat e AK për siguri dhe shëndet në punë por është edhe mjet motorik i cili krijon zhurme të madhe akustike e ku në të njejtën kohë mund të pengoj edhe proceset e ligjërimit në hapësirat e brendshme të UP-së.

Pothuajse në të gjitha pyetjet e OE dhe kërkesat për rishqyrtim të bëra nga OE në AK kanë qenë si kërkesa për eliminimin e këtij kriteri apo përmirësimin e tij. Kurse përgjigjet e AK dhënë në kërkesat për rishqyrtim e kanë berë edhe më konfuze këtë kërkesë të AK-së të vendosur si kriter favorizues/diskriminues.

Prandaj, duke vlerësuar që AK ka bërë shkelje esenciale të LPP dhe RRUOPP gjatë hartimit të dosjës së tenderit, kërkojmë nga OSHP qe ta anuloj kete aktivitet te prokurimit dhe te kërkoj nga AK qe gjate rishpalljes se kësaj procedure ti eleminoj ose te largoj disa nga kërkesat te cilat janë favorizuese për ndonjë OE diskriminuese per OE tjerë.